



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M


Nr. 08, datë 21.02.2020

“Mbi propozimin për miratim në Bankën e Shqipërisë në funksionin e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, të Politikës së administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”

Në mbështetje të nenit 43, pika 1, shkronja “m/1” të Ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 71, pika 2 dhe të nenit 73 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 15, pika 3 të rregullores “Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij” të miratuar me vendimin nr. 56, datë 3.10.2017 të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë, të nenit 6, pika 1, shkronja “j” të Statutit të Agjencisë, të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18, pika 2 të rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 29, datë 03.11.2014, si dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Të propozojë për miratim në Bankën e Shqipërisë në funksionin e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme “*Politikën e administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme*”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të propozojë për shfuqizim në Bankën e Shqipërisë “*Politikën e administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme*”, të propozuar me vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 34, datë 12.12.2017 dhe të miratuar nga Zëvendësguvernatori i dytë i Bankës së Shqipërisë, me shkresën nr. 5587/1, datë 10.01.2018.



KËSHILLI DREJTUES

3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për dërgimin e këtij vendimi në Bankën e Shqipërisë në funksionin e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar